



BASHKIA
TIRANË

R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Dt. 06.05.2022]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

OPERATORIT EKONOMIK “ALBTELECOM” sha

Adresa: Tirane Rruga "Muhedin Llagami" Kompleksi Square 21, Tirane, Shqiperi".

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Ofrimi i Shërbimit Online për Monitorimin e Trafikut” me Nr. reference REF-23575-03-30-2022** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 43 datë 4 Prill 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1 Operatori ekonomik ”COMMUNICATION PROGRESS” shpk NUIS K01625001C

Vlera e ofertës pa tvsh = 20,534,000 (njëzet milion e pesëqind e tridhjetë e katër mijë) lekë.

2 Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” sha NUIS: K11715005L

Vlera e ofertës pa TVSH– 20,215,200 (njëzet milion e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.

2 Operatori ekonomik “ALBTELECOM” sha NUIS: J61824053N

Vlera e ofertës pa TVSH– 18,676,960 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

• **Operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k, NIPT K01625001C**

Për arsyet e mëposhtme:

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.3.të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.3 Operatori duhet të jetë i regjistruar në RIPE. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të regjistrimit pranë RIPE NCC.

Operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

II. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.4 Operatori duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.

Operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

III. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.5/d të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme të cilësisë:

.....

d) BS PAS 99 (e përditësuar) për sistemin e integruar, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalente.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

Operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k, nuk ka paraqitur dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

IV. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.6 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe manaxhimin me profesionalizëm të punës dhe garantimin e vijueshmërisë së shërbimit në të gjitha vendndodhjet e kërkuara, duhet të përmbushë minimalisht kushtet e mëposhtme:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin tekniko-profesional staf të certifikuar si më poshtë:

- *Të paktën 3 (tre) punonjës të pajisur me certifikatë CCNA Certified Network Associate Routing & Switching ose ekuivalente;*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë CS PS Core Network Planning, ose ekuivalente;*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë LTE EPC Signalling ose ekuivalente;*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar SCTE ose ekuivalente.*

Një punonjës mund të ketë 1 ose më shumë certifikime.

Për të vërtetuar këtë operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Certifikata për specialistët e kërkuar;*
- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B;*
- *Listëpagesat sipas formularit E-Sig 025/a për muajin e fundit të deklaruara sipas legjislacionit në fuqi, paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B.*

Operatori ekonomik “Communication Progress” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion/certifikata të stafit sipas kërkesave të këtij kriteri.

Sa më sipër, KVO konstaton se operatori ekonomik “Communication Progress” Sh.p.k, nuk ka përmbushur kriteret 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5/ d, 2.3.6 pjesë e kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të kualifikimit, shtojca 8 e dst.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2 Operatori ekonomik “VODAFONE ALBANIA” sha NUIS: K11715005L

Për arsyet e mëposhtme:

Autoriteti kontraktor, për këtë procedurë prokurimi objekt vlerësimi, në pikën 2/1/b, të kriterëve të vecanta të kualifikimit (shtojca 8), ka kërkuar:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

....

b. “ Sigurimin e Ofertës sipas Shtojcës 3”

Operatori ekonomik “Vodafone Albania” sh.a, nuk ka paraqitur dokumentacion në spe për përmbushjen e këtij kriteri.

Në gjykim të sa më sipër dhe për ekonomi të procedurës administrative, ndodhur para faktit që mungesa e dokumentacionit provues për pikën 2/1/b të formularit të kriterëve të përzgjedhjes /kualifikimit, e bën të pamundur kualifikimin e operatorit ekonomik “Vodafone Albania “ sh.a, K.V.O ndal vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur në spe nga OE duke e s’kualifikuar nga procedura e prokurimit me objekt “Ofrimi i Shërbimit Online për Monitorimin e Trafikut”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**ALBTELECOM**” sha, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 18,676,960 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e Sukseshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.